

V E N D I M
Nr.401, datë 31.7.1995

**PËR RREGULLAT E PRANIMIT TË MOTOSKAFËVE DHE MJETEVE TË LEHTA TË
TURIZMIT NË PORTET E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Motoskafët dhe mjetet e lehta të turizmit, të cilat vijnë për në portet e Republikës së Shqipërisë, me hyrjen në ujërat territoriale, të njoftojnë menjëherë me radio kapitenerinë e portit. Në rast se nuk disponojnë mjete radiondërlidhjeje, me të ndërritur, të kontaktojnë me kapitenerinë e portit.

2.Drejtoritë e porteve në Shëngjin, Durrës, Vlorë e Sarandë të caktojnë bankinat (kalata të veçanta) për akostimin e motoskafëve dhe mjeteve të lehta të turizmit.

3.Kapiteneritë e porteve të disiplinojnë qëndrimin e këtyre mjeteve në vendet e caktuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi